



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 12.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit
2. Diskutimi në parim i të ardhurave të projektbudgetit 2019.

**Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

**Mungojnë:**

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

**Të ftuar:**

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Jonida Kaza- Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Erjon Braçe** – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Sot në rendin e ditës së punës së këtij komisioni rikthehemi të shqyrtojmë buxhetin e shtetit për vitin 2019.

Sipas kalendarit të punës së komisionit të lajmëruar edhe më herët do të diskutojmë të ardhurat e buxhetit të vitit 2019.

Do të fillojmë me një prezantim të ministrit të Financave, zotit Arben Ahmetaj, lidhur me këtë çështje, pastaj do të vazhdojmë me relatorin e komisionit dhe më pas me pyetje e diskutime deri në fund.

Zoti Ministër, fjala për ju.

**Arben Ahmetaj** – Faleminderit!

Programi i të ardhurave për vitin 2019 mbështet synimet e qeverisë për konsolidimin e mëtejshëm fiskal, reduktimin e deficitit buxhetor dhe uljen e borxhit publik.

Programi i të ardhurave për 2019-ën bazohet në katër shtylla, si: përmirësimin e administrimit fiskal, minimizimin e informalitetit në ekonomi, rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit dhe nxitjen e prodhimit vendas dhe eksporteve.

Të ardhurat të programuara në buxhetin e vitit 2019 gjithsej janë 486.5 miliardë lekë. Pra 30.6 miliardë lekë më shumë se viti 2018 ose 6,71 %.

Të ardhurat tatimore janë 447,2 miliardë lekë, pra kanë një rritje prej 28 miliardësh ose 6,65 % më shumë krahasuar me vitin 2018

Të ardhurat nga tatimet, doganat dhe sigurimet janë 425,5 miliardë lekë, pra janë 26.6 miliardë lekë ose 6,7 % më shumë krahasuar me vitin 2018

Në programimin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për vitin 2019, janë marrë në konsideratë të gjithë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve, politikat e reja fiskale, si dhe efektet nga lufta kundër informalitetit, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Programimi i të ardhurave për vitin 2019 është në linjë me synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidimin e mëtejshëm fiskal, reduktimin e deficitit buxhetor dhe borxhit publik, si dhe përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, në mbështetje të rritjes ekonomike të qëndrueshme, duke nxitur rritjen e prodhimit dhe eksportet.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, si dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë mbi secilën taksë dhe tatim. Modelet bazë të përdorura janë:

Parashikimet makroekonomike.

Modeli bazuar në analizën e 60-grup produkteve kryesore në import dhe analizën e serive kohore të tyre.

Modeli bazuar në koeficientin e elasticitetit “*Buoyancy*” dhe “*Effective Tax Rate*” për çdo taksë.

Këto modele bazohen në të dhëna historike 4-vjeçare të importeve dhe të ardhurave doganore për 60-grup produktet kryesore, analizojnë tendencën e ndryshimit të sasive të importuara për të njëjtat periudha në 4 vjet, marrin në konsideratë faktorë të tjerë të konstatuar gjatë vitit korrent, matin dhe vlerësojnë efektet bazuar në indikatorë makroekonomikë duke analizuar efektin në ndryshimin e të ardhurave për përqindje të ndryshimit të prodhimit të brendshëm bruto, duke iu referuar “*Buoyancy*” dhe “*Effective Tax Rate*”.

Në terma konkretë, në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Janë analizuar në veçanti sasitë dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit dhe prodhimit vendas që mbulojnë mbi 90% të vlerës së të ardhurave totale, duke marrë në konsideratë rritjen nominale të prodhimit të brendshëm bruto, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare tek taksat *ad-valorem*, si: tatimi mbi vlerën e shtuar, renta minerare dhe taksa doganore.

Kursin e pritshëm të këmbimit të dy monedhave kryesore, dollarë dhe euro, me lekun.

Çmimet e bursës që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe renta minerare.

Sasitë e pritshme të importit të mallrave.

Rritjen e të ardhurave nga akciza për karburantet, cigaret dhe pijet, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre, në përputhje me konsumin. Janë programuar të zhdoganohen +200 tonë ose 6,9% më shumë cigare krahasuar me realizimin e pritshëm të 2018-ës. Po kështu, është parashikuar rritja prej 4% e importit të karburanteve bazuar në ecurinë e vitit 2018, konsumit të karburanteve në përputhje me rritjen ekonomike dhe nevojat e tregut.

Ndryshimin e çmimeve të karburanteve, sipas publikimeve të “*EIA- U.S Energy Information Administration*”, pra një institucion referencë.

Rritjen e të ardhurave nga TVSH-ja në import dhe TVSH-ja brenda vendit, e shoqëruar me programimin e fondeve të nevojshme për rimbursimin në kohë të tatimpaguesve.

Rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.

Të ardhurat tatimore nga tatimet, dogana dhe kontributet për sigurime për vitin 2019, vlerësohen të jenë në shumën rreth 424,5 miliardë lekë, pra 26,4 miliardë lekë më shumë. Këto të ardhura do të jenë sa 24,2% e prodhimit të brendshëm bruto.

Këtu kemi një tabelë të detajuar se si i kemi bërë parashikimet që nga projekti bazë i 2018-ës, pra pritshmëritë, gjithë të ardhurat që janë “one-off” ose që realizohen vetëm një herë e nuk kanë frekuencë të përvitshme, pastaj kemi të llogaritur rritjen e të ardhurave nominale, efektin e deflatorit dhe masat fiskale. Për vitin 2019 kemi një sërë masash fiskale që ne i përmendëm para disa ditësh në komision. Parashikimi i të ardhurave tatimore sipas llojit të tatimeve për vitin 2019.

Të ardhurat nga TVSH-ja parashikohen të jenë 153,3 miliardë lekë, pra 9.5 miliardë lekë më shumë se pritshmëria për vitin 2018, me një rritje prej 6,6%. Brenda rritjes së TVSH-së në vitin 2019 do të jenë:

TVSH-ja që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve, TVSH-ja nga rritja e volumit të importeve dhe konjunktura e çmimeve ndërkombëtare,

TVSH-ja nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.

Të ardhurat nga akciza vlerësohen të jenë 48,3 miliardë lekë, me një rritje prej 2,8 miliardë lekë ose 6,2% më shumë se pritshmëria e vitin 2018. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza janë: programimi i rritjes me 200 tonë cigare krahasuar me pritshmëritë e vitit 2018; rritja me 4 % e importit dhe prodhimit të karburanteve; rritja e akcizës së cigareve me 3 lekë paketa, e planifikuar në bazë të skedulit me efekt 0,46 miliardë lekë; rritja e të ardhurave nga akciza e duhanit dhe zëvendësuesve të tjerë; lufta kundër informalitetit; kontrolli rigoroz i subjekteve të akcizës, si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin vlerësohen me rritje 7% ose 2,2 miliardë lekë më shumë se viti 2018, pra parashikohet të arkëtohen 33,5 miliardë lekë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet: së pari, në rritjen ekonomike të parashikuar, çka do të reflektohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve.

Së dyti, në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.

Së treti, në kontributet fiskale që do të gjenerohen nga sektori energjetik, i cili vitin e kaluar, për hir të së vërtetës, nuk dha tatimfitimi dhe nuk kontribuoi në rritje, pra në vitin 2017, por përkundrazi kërkoi mbështetje nga buxheti i shtetit.

Theksoj se performanca në tatimin mbi fitimin e vitit 2018 dhe rritja relativisht e ulët krahasuar me vitin 2017, lidhen me situatën energjetike që kaloi vendi në vitin 2018, e cila u reflektua në bilancet dhe kontributet fiskale, pra ajo që thashë pak më lart.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohen 41,9 miliardë lekë, me një rritje prej 12% ose 4,5 miliardë lekësh më shumë se viti 2018.

Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë rritja normale ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare; rritja e numrit të të punësuarve, bazuar në ecurinë e vitit 2018; ulja e të ardhurave nga rritja e pragut të taksimit të pagave me tarifën 23 %, që vlerësohet në minus 320 milionë lekë dhe ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15 % në 8%.

Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera vlerësohen të jenë 41,2 miliardë lekë. Për këtë taksë parashikohet që për vitin 2019 të ketë afërsisht 3% ose 1,1 miliardë lekë më shumë se i pritshmëria e 2018-ës. Këtu kemi edhe efektin nga mbyllja e lojërave të fatit, që shkon i kombinuar deri në 7 miliardë, efektet e ndryshimeve në taksën e ambalazheve plastike dhe taksën e rentës, gjithashtu.

Të ardhurat nga taksa doganore në vitin 2019 vlerësohet të jenë 7,4 miliardë lekë, me rritje 390 milionë lekë ose 5,6 % krahasuar me vitin 2018. Realizimi i pritshëm parashikohet të jetë 7 miliardë lekë. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Parashikimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vitin 2019.

Të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore në vitin 2019 parashikohen të rriten me 7%, ose me 6,4 miliardë lekë, krahasuar me të pritshmërinë e vitit 2018. Të ardhurat nga kontributet pritet të jenë 97,9 miliardë lekë, nga 91,5 miliardë lekë që do të arkëtohen në vitin 2018. Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet nga këta faktorë: rritja ekonomike; forcimi i administrimit, ku të dyja kombinojnë dhe rritjen e numrit të të punësuarve; rritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet në dy-tri vitet e fundit dhe efektin e rritjes së pagës minimale që nga 1 janari i vitit 2019, që sot është 24 dhe ne po

bëjmë kalkulimet tona për 25 dhe 26 mijë lekë, por ende nuk është marrë një vendim në nivelin e Kryeministrit.

Risqet fiskale shoqërojnë të gjithë planifikimin dhe lidhen natyrshëm si çdo vit me realizimin e të ardhurave të programuara nga tatimet, doganat dhe kontributet e sigurimeve, të cilat konsistojnë në rritjen me rreth 28% të çmimit Brent të naftës bruto, krahasuar me muajin gusht të vitit 2018.

Në planifikimin e të ardhurave është vlerësuar kompensimi i luhatjeve të mundshëm të çmimit, nëpërmjet disiplinimit maksimal të rasteve të përjashtimeve dhe rimbursimeve përtej normave ligjore dhe parashikimeve.

Është parashikuar një rritje me 200 tonë e importit të cigareve me një efekt në të ardhura nga TVSH-ja, akciza dhe taksa doganore, por që sigurisht mund të mos realizohet 100 %.

Është parashikuar rritja e importit dhe prodhimit vendas të karburantit me 4%, bazuar në performancën e vitit 2018. Në rast se nuk verifikohet kjo rritje, mund të shkojë me efekt negativ deri në 1 miliardë.

Mosrealizimi në masën e projektuar i të ardhurave nga tatimi mbi dividendin, që lidhet me incentivimin e shpërndarjes së fitimeve të mbartura nga vitet e kaluara, me afat kohor shtatorin. Pra këtu kemi një risk me të paktën 1,5 miliardë lekë.

Kjo ishte një përmbledhje e detajuar e gjithë platformës që qëndron përtej planifikimit të të ardhurave. Këtu po ndaloj prezantimin dhe me kënaqësi do të prisja opinionet ose pyetjet.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Angjeli, si relator i komisionit për projektbuxhetin.

**Anastas Angjeli** – Shkurtimisht dua të them pak fjalë, pasi në prezantimin në tërësi të buxhetit u fokusuam te opinionin ynë i dhënë për programin e të ardhurave, por duke dëgjuar edhe analizën që bëri ministri, pa dyshim që nuk dua të biem në të njëjtën përsëritje. Ajo që është e rëndësishme, që edhe nga prezantimi del në pah, është se të ardhurat e buxhetit të vitit 2019 janë mbështetur në objektivat kryesorë të rritjes ekonomike, në konsolidimin fiskal dhe në politikat e reja që ka qeveria në fushën fiskale dhe veçanërisht për administrimin fiskal dhe reduktimin e informalitetit. Me renditjen e një sërë faktorëve që janë bërë për analizën e të ardhurave dhe për risqet, unë them se mund të dalin dy-tri pyetje që mund të kërkojnë një sqarim të mëtejshëm.

Së pari, për opinionin, por edhe për ne këtu duhet bërë e qartë se mbi çfarë baze bëhet krahasimi i të ardhurave të buxhetit të vitit 2019, në krahasim me buxhetin e vitit ushtrimor që ne jemi? Duke konsideruar që përgjithësisht duhet mbajtur parasysh realizimi i pritshëm i këtij viti, pa dyshim që treguesit e paraqitur duket se janë në linjën e realitetit të buxhetit të vitit që ne jemi dhe në vazhdim, duke mos e konsideruar thjesht një krahasim me aktin e fundit normativ që përbën programin e fundit buxhetor, sepse po të bëhet ky krahasim, natyrisht që mund të dalin disa tregues ndryshe.

Ajo që dua të them dhe që është e rëndësishme është që ne kemi një rritje më shumë absolute të të ardhurave, e cila pavarësisht nga intensiteti apo ritmi vjetor i rritjes së tyre, i cili ndryshon nga një vit në vitin tjetër, ka vite që ky ritëm është më i fortë dhe ka vite që është më i ulët. Unë them që është e rëndësishme të shtrojmë pyetjen dhe t'i japim përgjigje: a është një parashikim optimist dhe realist i të ardhurave? Ne këtë duhet ta themi. Përse e them këtë? Ose duhet të sqarojmë më mirë përse në raport me GDP-në të ardhurat e vitit 2019 dhe të dy viteve në vazhdim, sipas programit të buxhetit afatmesëm, ruajnë nivelin ose janë më në ulje se sa ato që keni parashikuar të realizoni në vitin 2018. Nëse ne i kemi të ardhurat 28,2% për këtë vit dhe nëse themi 27,8%, ndërkohë që GDP-ja rritet dhe të ardhurat e shuma absolute rriten, mbase ka nevojë që të shpjegohet qartë ky moment të paktën në të dhënat që janë paraqitur në relacion.

Momenti i dytë, që duhet shpjeguar, mbase ia vlen për ta bërë më të qartë, është ai faktor i rëndësishëm që ne e kemi konsideruar në programin për të ardhurat, që është në tre faktorët që ishin: konsolidimi fiskal, rritja ekonomike dhe ai që ka të bëjë me miradministrimin fiskal dhe me reduktimin e informalitetit. Mbase këtu kemi nevojë të themi edhe paketën e masave që do të merren për reduktimin e informalitetit dhe për miradministrimin fiskal.

Së treti, është ai moment që ne debatuar gjatë paketës fiskale, një moment shumë i rëndësishëm dhe unë e kam dëgjuar të gjithë debatin dhe diskutimet, pra është çështja që ka të bëjë me tatimin mbi të ardhurat personale. Ky është një tatim i rëndësishëm dhe që është konsiderueshëm në shuma absolute, por edhe në përqindje në të ardhurat e buxhetit të shtetit. Po ta konsiderojmë si tatim mbi të ardhurat nga paga pjesën kryesore e të ardhurave personale, pa dyshim që nga pikëpamja e administrimit është tatimi më i lehtë që ekziston, sepse administrata fiskale bën shumë pak punë në këtë çështje. Tatimi mbahet në bordoro, në shumicën e rasteve, së bashku me taksat e tjera të sigurimeve dhe i xhirohet direkt administratës fiskale. Po ta shikojmë debatin nga këndvështrimi që zhvilluam radhën e parë, kemi një ndryshim në paketë nga qeveria në njërën nga shkallët e tarifave. Ne jemi të

vendosur te parimi dhe jo te llojet e tarifave. Ne jemi të vendosur te parimi që kemi thënë, që kush ka më shumë të ardhura, do të paguajë më shumë dhe kush ka më pak, paguan më pak. Por asnjë teori nuk mund të na bind ne që shkallët e tarifave janë të dhëna një herë dhe përgjithmonë dhe po lëvizëm njërën, humbëm këtë apo atë ekuilibër, sepse ne kemi kalkulimin tonë në buxhet se sa të ardhura sigurojmë në buxhet nga të ardhurat personale. Por rëndësi ka që ne të ruajmë parimin, sepse tarifat mund të jenë me progresion të fortë ose të butë, por mund të jenë dhe regressive. Pra, të ruajmë parimin dhe të mos prishim ekuilibrin fiskal që kemi në buxhetin e shtetit. Në këtë këndvështrim mbase kur të vijë koha në shqyrtimin nën për nën te ligji përkatës, ashtu siç e kemi diskutuar, do ta ridiskutojmë në bazë të një vendimi edhe më të ngushtë që mund të kemi marrë, nëse do t'u qëndrojmë tarifave që kemi, apo do të ndryshojmë një që është propozuar, apo do të ndryshojnë dy duke ruajtur nivelin e pagave të ulëta të paprekshme.

Them se këto tri momente në çështjen e diskutimit të të ardhurave, do të na jepnin më shumë bindje dhe informacion për atë që thashë në fillim, që ne jemi mbase jo optimist, por jemi më afër realitetit të të ardhurave, duke e krahasuar me faktin e vitit 2018, sesa me aktin e fundit normativ që është plani i vitit 2018.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit, zoti Angjeli!

Po, zoti Ministër.

**Arben Ahmetaj** – Në referencë të asaj që thatë, siç e shpjegova në detaje, planifikimi është bërë shumë i detajuar dhe po ta shikoni ka 3 vjet që qeveria shqiptare së bashku me maxhorancën kanë bërë ulje drastike, relaksim dhe përjashtime të konsiderueshme nga taksat. Praktikisht këto relaksime janë të konsideruara për të ulur barrën fiskale për qytetarët. Dua t'ju kujtoj dy ose më shumë shifra parimore që ky komision duhet t'i dijë. Kur them që duhet t'i dijë, nuk them që nuk i di, por që në këtë moment duhet të theksohen.

Mos harroni që sot kemi 91% të kompanive që taksohen 0 ose 5%. Pra, mos harroni që kemi krijuar një grup shumë të madh kompanish që tatohen shumë pak me 5% dhe një grup shumë të madh kompanish që tatohen me 0%. Këtë relaksim e kemi bërë këta 2 vjet.

Mos harroni që kemi reduktuar TVSH-në për shumë produkte dhe sektorë.

Mos harroni që janë 55% e të punësuarve që paguajnë 0 tatim mbi të ardhurat personale. Ky sistem fiskal ka 91% të kompanive me 0 ose 5% dhe 55% e të punësuarve me 0 taksë. Përtej kësaj, po jua them si kolegë, si miku juaj dhe si ministër i Financave që *tax expendegers*, përjashtimet fiskale të tri viteve të fundit e kanë relaksuar shumë barrën fiskale në drejtim pozitiv. Ndërkohë që jemi vënë në konsolidim fiskal, duke ulur borxhin dhe me të



gjithë goditjen e madhe që kemi marrë në TVSH, për shkak të kursit të këmbimit, po të shikoni rritjen e TVSH-së bruto është në nivele të shëndetshme.

Kemi rritur dyfish rimbursimin, për shkak të trashëgimisë të shumë viteve më përpara, të akumulimit të TVSH-së së rimbueshme, siç është rasti i TAP-it që ka punuar 5-6 vjet dhe vjen të rimburohet në 1 dhe 2 vjet. Sigurisht, është përgjegjësi.

Pra dua t'ju kujtoj se vetëm në 2 vjetët e fundit kemi përjashtuar dhe ulur taksën për turizmin, agroturizmin dhe SHBB-të, të cilat influencojnë seriozisht në vitin 2019. Megjithatë nuk e kemi ulur parashikimin fiskal dhe në përqindje të GDP-së, sepse nëse ngushtohet baza e taksueshme, duhet të presim reduktimin dhe përqindjen ndaj GDP-së, por nuk e kemi bërë atë. Me gjithë goditjen e madhe që merr buxheti vitin tjetër për shkak të këtyre elementeve, këtu nuk kam futur fare, në numrimin e goditjeve, të ardhurën e munguar që do të jetë në vitin 2019 nga lojërat e fatit. Ne kemi bërë një lëvizje shumë kurajoze dhe shumë pozitive për qytetarët, pra kemi bërë një ndalesë të plotë të kazinove elektronike, basteve, sallave me baste sportive, basteve *online* dhe basteve në pista, por niveli është rreth 7 miliardë.

Pra, kjo maxhorancë ka hyrë në një trajektore relaksimi, e cila duhet balancuar, për tri vite vetëm ul taksa, vetëm përjashton, vetëm ul nivele të TVSH-së dhe ul ngarkesa në sektorë të ndryshëm në funksion të lehtësimit të barrës fiskale për qytetarët dhe për sipërmarrjen.

Këtu po e mbyll duke ju kujtuar se 91 e ndërmarrjeve taksohen me 0 ose 5% dhe 55% e të punësuarve nuk paguajnë tatim mbi të ardhurat personale. Pra përtej relaksimit serioz, që ne u kemi bërë sektorëve, të mos harrojmë që jemi ekspanduar natyrshëm në legjitimitet të plotë të asaj që përfaqësojmë në paketën sociale të shpenzimet. Pra, ky komision asnjëherë nuk duhet të harrojë relaksimin e masave që kemi marrë, pra uljen e barrës fiskale për qytetarët dhe për ndërmarrjet, detyrimin për të ulur borxhin, ekspandimin, zgjerimin social që kemi bërë të shpenzimet dhe investimet që kemi në nivel 5% të prodhimit të brendshëm bruto.

Për sa i përket miradministrimit, e keni edhe në relacion të parashikuar, që miradministrimi si akademiksht dhe në eksperiencë ka kontributin e vet në rritjen e të ardhurave vitin tjetër. Ka edhe një element shtesë, që mendoj se do të influencojë pozitivisht, që është sistemi i fiskalizimit, pra sjellja e të gjithë transaksioneve në kohë reale *online*, si biznes me biznes, ashtu dhe biznes me konsumator. Jam i bindur që nëse sistemi do të ecë ashtu siç parashikohet, që në maj dhe qershor, në kuadrin e parë të transaksioneve, ta ketë të skanuar, sigurisht është një masë plus antiinformalitet.

Më pyetët për ndryshimin e TAP-it, për tatimet dhe të ardhurat personale, por këto do t'i diskutojmë kur të vijmë nen për nen. Kështu, besoj se janë 55% të punësuarve që janë jashtë sistemit fiskal, pra që nuk kontribuojnë në mënyrë fiskale trajtimet dhe të ardhurat personale. Ne kemi një propozim që ta ulim pragun, nga 300 ta çojmë në 100 ose t'i fusim të gjithë në një sistem takse me 1,5%. Unë e kam bërë një propozim dhe besoj se do të diskutohet në të ardhmen, që t'i fusim të gjithë kontribuuesit me 1,5% tatim të ardhurash personale dhe bëjmë të gjithë gamën e të punësuarve brenda sistemit të kontributeve fiskale.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Kush ka pyetje?

Po, zoti Bushati.

**Ervin Bushati** – Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, një nga indikatorët kryesorë për mendimin tim është TVSH-ja dhe mbledhja e saj. Ne kemi pasur një nismë dhe e kemi mbështetur të gjithë bashkë në sinkron për formalizimin dhe përfshirjen në skemën e TVSH-së. Pavarësisht goditjes së monedhës, gjë që është normale, dhe të gjithë shpresojmë që të jetë në të njëjtin pozicion, a mund të na thoni diçka më shumë si po shkon formalizimi nëpërmjet TVSH-së, që të futet i gjithë zinxhiri që nga fillimi? Ky ishte dhe dakordësia që patëm me bizneset e vogla, ulëm tatim fitimin pikërisht që të stimulojmë formalizimin ekonomisë nëpërmjet futjes së TVSH-së. Si mendoni se do të shkojë vitin e ardhshëm, sepse kjo nuk është vetëm një nga parametrat kryesorë të ardhurave të buxhetit, por edhe të matjes së formalizimit të ekonomisë?

**Arben Ahmetaj** – Po të shikoni planifikimin për sa i përket TVSH-së, ai shkon gati 10 miliardë plus në vitin 2019, pra është një vlerë e konsiderueshme gati 6,6%. Ne jemi duke folur për neton, por nëse do të flasim për bruto rritja është më e madhe, sepse ne kemi planifikuar më shumë rimbursime për vitin 2019 për të atakuar të gjitha detyrimet që ne kemi për kompanitë e mëdha, si: TAP-i , “Ayen”-i apo disa kompani të tjera, të cilat kanë akumuluar ndër vite për shkak të investimeve shuma të mëdha të kreditueshme apo edhe të rimbursueshme.

Unë marr shkas t'ju them se duhet të jemi shumë të kujdesshëm për sa i përket TVSH-së. Në këndvështrimin tim personal, është brenda tatimeve indirekte dhe është tatimi më i mirë, në kuptimin e kontributit në buxhetin e shtetit, por edhe tatimi më i mirë në aspektin e skanimit të transaksioneve ekonomike. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm me çdo devijim ose çdo përjashtim që bëjmë tek TVSH-ja. Unë personalisht do të rekomandoja

zero përjashtime nga TVSH-ja, në mënyrë që ta mbajmë të konsoliduar të gjithë rrjetën fiskale.

Tjetër është edhe sistemi teknologjik i fiskalizimit, që do ta ndihmojë shumë lidhjen e transaksionit ndërmjet të mëdhenjve dhe të vegjëlve. Siç e shikoni, nuk ka pasur asnjë problem në terrenin ekonomik qoftë në aspektin e gjobave, qoftë në aspektin e miradministrimit apo keqadministrimit. Pra, ne po monitorojmë një periudhë 6-mujore, duke filluar nga data 1 korriku i viti 2018, për të parë se si po na ecën pjesa e detyrim deklarimit të bizneseve me xhiro mbi 2 milionë lekë. Sigurisht, mbi këto do të ndërtohet edhe logjika e fiskalizimit, që do të na ndihmojë në skanimin e transaksioneve të plota, por, siç premtoi Kryeministri, nuk do të ketë asnjë gjobë për gabime në deklarime dhe e vërteta kjo është. Sigurisht, që është në periudhë e freskët, sepse nuk kanë kaluar as 5 muaj.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Urdhëroni, zonja Kushi!

**Evis Kushi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Natyrisht që realizimi i të ardhurave është një nga objektivat më të rëndësishëm të buxhetit, i cili ndikon edhe tek treguesit e tjerë buxhetorë, si realizimi i shpenzimeve apo investimeve publike. Ndërkohë, vetë realizimi i të ardhurave ndikohet nga shumë faktorë, përballet me shumë sfida dhe risqe të shumta, disa nga të cilat ju i përmendët, siç ishte performanca e administratës tatimore.

Unë dua të ndalem pak më shumë te këto risqe. Cilat janë risqet më të mëdha, me të cilat përballet realizimi i të ardhurave të buxhetit? Çfarë masash keni marrë apo duhet të merrni, në mënyrë që ta realizoni sa më mirë këtë objektiv? Për shembull, një faktor ose risk ndoshta është edhe performanca e ndërmarrjeve me kapitale shtetërore, siç është OSHEE-ja ose OST-ja. Sa ndikon kjo performancë? Çfarë masash duhet të marrim ne, në mënyrë që në fund të ditës ta realizojmë sa më mirë objektivin e grumbullimit të të ardhurave?

Faleminderit!

**Arben Ahmetaj** – Faleminderit për pyetjet!

Në këndvështrimin tim jo vetëm personal, por edhe në pozicionin që kam, mund të them se risku më i madh i të ardhurave është sidomos kur buxheti performon mirë. Pse ndodh kjo? Sepse në përgjithësi qeveritë apo grupet parlamentare, kanë tendencë që të relaksojnë kuadratin fiskal me logjikën politike, por edhe me logjikën ekonomike, kuptohet në anën e shpenzimeve të ekspandojnë paketat sociale. Besoj se kjo duhet të ketë një balancë, sepse, sipas meje, ky është risku më i madh yni. Kjo maxhorancë, në aspektin fiskal, është tejet e maturuar në detaje dhe besoj se edhe ju, si Komision i Ekonomisë, e dini se sa e rëndësishme

është të mos e zhbëjmë. Pra, ky është risku i parë që ne të mos zhbëjmë pa dashje kuadrin fiskal, duke mos marrë parasysh asnjë nga problematikat, që mund t'i vijnë vendit në të ardhmen, që mund të jenë një shok makroekonomik dhe një goditje te kursi i këmbimit, siç tashmë e kemi. A e dini se deri në shtator ne kemi me 6,6 miliardë TVSH-në? A e dini se deri në fund të vitit do të shkojë 90 miliardë, gati 100 milionë dollarë TVSH-në? Pra, ne do ta kemi gati 9 deri në 10 miliardë dhe kjo ndodh vetëm nga kursi i këmbimit. Ne duhet të bëhet një balancim dhe ky është risku kryesor për mendimin tim.

Në të gjitha eksperiencat botërore gabimet bëhen kur çdo gjë ecën mirë. Natyrshëm grupet politike mendojnë se do të ecin gjithmonë mirë dhe bëjnë zgjerimet ose relaksimet e tyre fiskale, ndërkohë kur vjen problematika, siç e kanë shumë vende të Europës, e gjejnë veten pa amortizatorë makroekonomikë dhe goditja shkon drejtpërdrejt te qytetarët. Këtë gjë ne nuk duhet ta lejojmë, sepse personalisht, kur kam qenë në pozicione shumë modeste, e kam parë t'i ndodhë vendit në vitin 1996, 1997, 2011 dhe 2012. Ne nuk duhet të parashikojmë, sepse ta parashikosh do të thotë që të jesh shumë i kujdesshëm në kuadrin fiskal kur propozojmë, qoftë edhe në pjesën e shpenzimeve. Ky është risku i parë.

Risku i dytë është ekonomia europiane. Po të shikoni parashikimet, nuk janë më aq optimiste dhe automatikisht partnerët tanë tregtarë preken nga rritja. Partnerët tanë preken nga ritmet e rritjes, që janë më të ulëta se parashikimet dhe tregjet e tyre do të kenë influenza mbi eksportet tona apo mbi importet tona.

Risku tjetër është kursi i këmbimit. Mos harroni se një lëvizje gjysmë interesi na godet menjëherë 3 miliardë në koston e interesave. Pra, në qoftë se në 2-3 muaj interesi në Europë apo në SHBA lëviz me atë tendencë që tashmë është shpallur, atëherë goditja do të jetë menjëherë 3 miliardë e gjysmë për qind. Imagjinojeni nëse do të jetë me 1%.

Siç ju thashë, administrimi është një instrument, nuk është risk, por sigurisht që influencon tek të ardhurat totale.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Po, zoti Bushati!

Më pas fjalën e ka zonja Gjylameti.

**Ervin Bushati** – Faleminderit!

Në fakt, siç e thatë, korrektimi i monedhës euro ka qenë një faktor i konsiderueshëm, sepse ne kemi një pjesë të madhe të shkëmbimeve tregtare.

**Arben Ahmetaj** – Më falni, edhe një herë, ju lutem!

**Ervin Bushati** – E kam fjalën për korrektimin e monedhës euro. Sipas jush, si ndodhi korrektimi i monedhës euro, në mënyrë që të parashikojmë që të mos kemi të njëjtën

gjë edhe nëse mbetet në këto nivele? Pra, si e keni bërë ju analizën në kohë? Ku është bazuar logjika që do të kemi këto të ardhura?

**Arben Ahmetaj** - Praktikisht kursi i këmbimit sa është i lehtë të parashikohet, aq është edhe i vështirë, pasi ka faktorë të jashtëm dhe ju e patë si lëvizti monedha euro brenda 3 ditësh me dollarin dhe më pas me të gjitha monedhat e tjera. Kancelarja Merkel deklaroi se do të tërhiqej nga të qenit kryetare e CDU-së dhe të gjithë e marrin si një ngjarje të izoluar, por kjo ngjarje influencon tek tregjet dhe tregjet na influencojnë neve.

Së pari, më e rëndësishme nga të gjitha është lëvizja e kursit të këmbimit, i cili u referohet fondamenteve ekonomike të Shqipërisë. Pra, është forcuar besimi i aktorëve tek ekonomia e vendit dhe te monedha vendase.

Së dyti, po kaq e rëndësishme është se eksportet janë rritur me dy shifra. Pra, rritja 9-mujore e eksporteve ka shkuar në 15,3% apo 15,4%.

Së treti, është turizmi, eksporti i shërbimeve, i cili është rritur në mënyrë të konsiderueshme po me dy shifra. Të gjitha këto bëjnë që kursi i këmbimit të lëvizë dhe leku të mbivlerësohet. Në njërin aspekt është shumë mirë, sepse pasuria e shqiptarëve vlerësohet më lart. Pra, debati ka qenë qesharak kur u forcua leku. Sigurisht, në kuadrin total makroekonomik dhe në bilancin e pagesave ka një problematikë, e cila korrektohet në kohë, por ne po flasim sot për goditjen që na jep tek të ardhurat, që pasuria shqiptarëve në aspekt me *Purchasing Power Parity* na ndihmon shumë dhe krijon më shumë fuqi blerëse te një rezident shqiptar që ka pagesat apo kursimet në lek. Nga ana tjetër, na dëmton për sa u përket të ardhurave nga importi, sepse na ulet baza e taksueshme në import, siç na ndodhi që goditja deri në fund të vitit shkoi nga 90 deri në 100 milionë dollarë. Megjithatë, ne kemi punuar me Bankën e Shqipërisë për të qenë në parashikime të pritshme të modeleve që ata ndjekin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Janë në një mesatare ndërmjet 26-ës dhe 28-ës, ku është ankoruar edhe parashikimi i Bankës së Shqipërisë.

**Erion Braçe** - Po, zonja Gjylameti.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, kam një pyetje në lidhje me të ardhurat tatimore, duke qenë se kanë zërin kryesor të të ardhurave të përgjithshme, sa vend zë lufta ndaj informalitetit në këto të ardhura tatimore?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë dua të di shifrat konkrete.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ndoshta unë nuk ju kam dëgjuar, por nëse keni mundësi ta përsërisni edhe njëherë?

**Arben Ahmetaj** – Patjetër!

**Blerina Gjylameti** – Nga ana tjetër, duke qenë se një pjesë e mirë e faktorëve në paketën fiskale do të kenë një efekt negativ, flasim për lehtësirat fiskale, do të ishte mirë që t'i kishim të detajuara, në mënyrë që të kuptojmë si dhe sa ndikon te gjithsecili. Përsëri për sa i përket luftës kundër informalitetit për vitin 2019, çfarë mase do të merrni që të ardhurat nga tatimet të jenë edhe më të larta nga çfarë kanë qenë?

Duke parë nga grafiku i të ardhurave të përgjithshme, ritmi i rritjes ka një rënie, pavarësisht rritjes së të ardhurave krahasuar me vitin 2018. Si mendoni për të gjitha ndërhyrjet që kemi te paketa fiskale, që shoqëron projektbuxhetin? Sa do të ndikojnë për të nxitur ritmin e rritjes ekonomike?

Faleminderit!

**Arben Ahmetaj** – Ju iu referuat uljes së ritmit, kurse unë po i referohem një rritjeje të ritmit. Pra, meqenëse ju thoni se 6,6 % është pak, unë po ju them se...

**Blerina Gjylameti** – Më falni, që të mos keqkuptohemi, unë thashë që të ardhurat rriten, ndërkohë që ritmi i rritjes ka një lloj uljeje.

**Arben Ahmetaj** – Ju thatë se ritmi i rritjes ulet, ndërkohë që është 6,6 -6,7%, që do të thotë se logjika realiste makroekonomike është në nivele të GDP-së nominale plus administrimin, pra është në nivele shumë të parashikuara realiste. Ne nuk bëjmë gabime të tilla, që të planifikojmë më pak apo më shumë, sepse po të bëjmë planifikime më pak nuk do të jemi realistë me mundësitë dhe do të vijmë ta korrektojmë. Ne nuk duam të shtiremi sikur po bëjmë çudira në mbledhjen e të ardhurave. Gjithashtu, nëse do të bëjmë planifikim më shumë dhe jo realiste, i bie që të zgjerojmë shpenzimet dhe pastaj të mos kemi mundësi të mbajmë deficitin. Në mënyrë artificiale po ju them se rritja me 6,6% është brenda çdo kuadri. Mos harroni se jemi ende duke diskutuar me FMN-në për të pritshmen përfundimtare, mbi të gjitha për të parashikuar goditjen nga kursi i këmbimit, që do të thotë se krahasimisht me vitin 2018 ritmi i rritjes së të ardhurave do të jetë shumë më i madh. Ne parashikojmë nga 1,3 deri në 2 miliardë vetëm për shkak të administrimit *perse*, ndërkohë që administrimi në tërësi kërkon zgjerimin e skanimit të rritjes ekonomike, që na sjell te rritja e bazës së taksueshme dhe automatikisht na sjell edhe të ardhura më të larta, të cilat konkludojnë dhe konsolidohen në 6,6%.

Faleminderit!

**Blerina Gjylameti** – Besoj se u keqkuptuam në atë çfarë unë kërkoja të di. Fakti që për vitin 2019 parashikojmë, sikundër ju thatë, të jemi sa më realistë, për realizmin, por

ndërkohë kur tejkalohet përsëri kemi një rishikim pozitiv, atëherë kur në relacion thuhet se ritmi i rritjes ka një lloj rënieje, pavarësisht rritjes së të ardhurave, pyetja që më vjen natyrshëm është: kjo është vetëm për shkak të parashikimit realist? Nga ana tjetër, lufta ndaj informalitetit apo edhe paketa fiskale, që është në nxitje të biznesit, lehtësirat për biznesin për të nxitur sektorë të rëndësishëm apo strategjikë, që ne kemi për ekonominë shqiptare, sa mund të jenë këto në linjë me atë që ju parashikoni, të ritmit të rritjes ekonomike dhe më pas të ritmit të rritjes së të ardhurave?

Faleminderit!

**Arben Ahmetaj** – Zonja deputete, unë jua thashë që gjithandej po ulen dhe po bëhen përjashtime në taksa dhe niveli me GDP-së po rritet. Ajo që ju iu referuat si ngadalësim nuk është e vërtetë. 6,6% është akselerimi i mbledhjes së të ardhurave, është përshpejtim i mbledhjes së të ardhurave dhe sigurisht që vjen nga shumë faktorë, që unë iu referova, siç është rritja ekonomike, që është në bazë të miradministrimit që ka konsekuencën e saj vit pas viti. Pra, ne nuk duhet të harrojmë se kemi ardhur me gati 24,6 të PBB-së dhe kemi ulur një masë të madhe taksash, sepse vetëm nga të ardhurat personale janë 120 milionë dollarë, të cilat shkojnë në buxhetin e shtetit në vit dhe në xhepat e qytetarëve.

**Erion Braçe** - Po, zoti Pëllumbi.

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, unë kisha disa pyetje që lidheshin me TVSH-në, por edhe me tatimin mbi fitimin, por meqenëse një pjesë e kolegëve i trajtuan këto probleme, më kanë mbetur dy gjëra të vogla, që ndoshta do t'i diskutojmë në të ardhmen për të mos rënë në përsëritje. Unë do të përqendrohem në dy pika:

Së pari, për vitin që vjen ne mendojmë se do të kemi një rritje prej 200 tonësh të konsumit të cigareve. Ndoshta nuk mund të realizohet e gjitha, por gjithsesi mendojmë të kemi një parashikim në rritje për vitin që vjen. Ndërkohë, edhe pse ju keni marrë dy masa të rëndësishme për vitin që vjen, qoftë në ligjin e ndalimit të duhanit në ambiente të mbyllura, qoftë në rritjen e akcizës, ne kemi efekte në rritje të konsumit të duhanit. A mendoni se kjo skemë e akcizës ndoshta do të ketë nevojë për një rishikim tjetër, sepse qëllimi final që kemi është ulja e konsumit të duhanit, të cilën me sa duket nuk po ia arrijmë? A mos ndoshta do të duhet ta rishikojmë përsëri skemën e akcizës në sens rritjeje, që të japë një efekt realisht në uljen e konsumit të duhanit?

Së dyti, ju thatë se 55% e të punësuarve në Shqipëri kanë ndikim zero në tatimin mbi të ardhurat personale. Tani në këtë 55%, a keni ndonjë ide se sa janë ata që realisht

marrin një pagë minimale dhe sa mund të jenë ata që deklarohen me pagë informale? Kjo pyetje bëhet për të menduar ndoshta më pas për skemën e taksimit të pagave.

Faleminderit!

**Arben Ahmetaj** – Faleminderit për pyetjet!

Praktikisht direktiva, por edhe tendenca për sa i përket akcizës është të shkojë në 90 euro për 1 mijë fije duhan. Ne ende e kemi në 60 euro dhe jemi shumë larg, që do të thotë se kemi një rrugë shumë të gjatë deri tek akciza.

Sipas informacioneve të mia të fundit nga rajoni ka një tendencë ngarkese të akcizës për mallrat e akcizueshëm në tërësi, por edhe për cigaren. Po të krahasojmë Shqipërinë me rajonin, vetëm Maqedonia e ka më të ulët, kurse të gjitha vendet e tjera e kanë shumë më të lartë. Unë nuk do ta krahasoj Shqipërinë me BE-në, sepse është larg në kuptimin dhe në distancë fiskale, por edhe në logjikë. Kështu që besoj se ndër vite nuk do ta quajmë korrektim të regjimit, por përkundrazi do ta quajmë ndjekje të trendit normal ndërkombëtar të trajtimit të mallrave të akcizueshëm dhe këtu po e ngushtoj te duhani.

Pyetja juaj e dytë ka të bëjë me një referencë të pagave të ulëta, sa janë reale dhe sa nuk janë reale. Kjo është një pyetje me vend. Nëse e mbani mend, më pak se një muaj unë i jam referuar një të dhëne nga tatimet, që 42% e të punësuarve VIP-a janë në nivel 300 mijë lekë të vjetër në muaj, gjë që është qesharake.

Beteja që ne kemi pasur me këta të punësuar VIP-a ka bërë që 42%-shi të ulet dhe sigurisht të deklarohen më shumë të ardhura mbi nivelin 300 mijë ose një deklaram më real në nivelet manaxheriale. Mos prisni që të ketë inxhinierë, që të punojnë me 400 mijë lekë të vjetër apo administratorë biznesesh me 600 mijë apo me 700 mijë lekë të vjetër, sepse nuk ka. Kjo nuk është e vërtetë dhe nuk ndodh. Kështu që kjo është një betejë e vazhdueshme dhe unë po ju them me bindje të plotë se ka hapësira për ta ngushtuar lakun e antiinformalitetit.

**Erion Braçe** – Urdhëroni, zonja Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Duke pasur parasysh realizmin e të ardhurave për 10-mujorin e vitit 2018, si mendoni se do të paraqitet realizimi i të ardhurave krahasuar me vitin 2017, njëkohësisht krahasuar me planin për vitin 2018, pasi, siç thatë, një faktor do të jetë edhe kursi i këmbimit, i cili do të ndikojë në realizmin e të ardhurave?

Faleminderit!

**Arben Ahmetaj** - Besoj se do të jemi në nivelin 98,3 të planit dhe dua t'ju bëj një krahasim për të pasur idenë se ku jemi. Vetëm TVSH-ja për shkak të kursit të këmbimit na



godet 9 miliardë dhe e gjithë goditja që planifikojmë të marrim në terma realë në fund të vitit do të jetë 7,5 miliardë. Pra, ju dhashë dy shifra për të kuptuar se çfarë jemi duke bërë, ndërkohë që vetëm goditja nga kursi i këmbimit është 9 miliardë, ne e rikuperojmë atë dhe e ulim në 7,5 miliardë. Vetëm nga lojërat e fatit ne jemi gati 1 miliard minus që këtë vit, që do të thotë: 9 edhe 1 baras 10, plus uljen e taksave. Megjithatë, shifra 7,5 apo 8 është rekord në vite, sepse po të mbani mend vitet 2011, 2012, 2013 e kishin goditjen 300 milionë dollarë ose 30 miliardë lekë.

**Erion Braçe** - A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime të tjera apo ndonjë opinion lidhur me të ardhurat, megjithëse një pjesë të madhe u konsumuan? Nuk ka.

Atëherë, prezantimin, sqarimin dhe diskutimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2019 e mbyllim këtu.

Sipas programit do të vijojmë ditën e nesërme me shpenzimet buxhetore, e kështu me radhë do të vazhdojmë me programin.

Këtu mbyllet mbledhja.

U lutem medieve të lirojnë sallën!

**MBYLLET MBLEDHJA**